



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:273832  
Datë: 22.03.2024  
Numri i dokumentit: 05490930

[Click here to enter text.](#) **PPP.nr.233/22**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit I.F., me seli në Prishtinë, Instituti B, kati përdhesë, rrethi i QKUK-së, kundër debitorit Mr.Ph H.T., F... në Spitalin e Përgjithshëm në Ferizaj, rr “Ramadan Rexhepi”, për pagesën e gjobës, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitori, me datë 22.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si i pabazuar prapësimi i debitorit Mr.Ph H.T., i ushtruar kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr.460/22, i datës 02.09.2022, i lëshuar nga përmbaruesi privat B.T. nga Ferizaj dhe **MBETET** në fuqi urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.460/22, i datës 02.09.2022.

**A r s y e t i m**

Me urdhrin P.nr.460/22, të datës 02.09.2022, përmbaruesi privat B.T., e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga kreditori I.F., kundër debitorit Mr.Ph H.T., për pagesën e gjobës në shumë prej 1,000 euro, në bazë të vendimit të formës së prerë dhe të ekzekutueshëm, me numër Nr:10/ ..., të datës 26.09.2019, duke i përfshirë edhe shpenzimet e procedurës së përmbarimit, ose ndalimin në mjetet në para përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit ose regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Kundër urdhrorit për lejimin e përmbarimit, debitori, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, duke i propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi si i bazuar dhe të anulohet urdhri për përmbarim.

Kreditori nuk ka ushtruar përgjigje me shkrim në prapësimin e të autorizuarit të debitorit.

Gjykata në këtë rast i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin për përmbarim P.nr.460/22, të datës 02.09.2022 dhe pretendimet në prapësim të debitorit dhe vlerësoj se prapësimi është i pabazuar dhe nuk i plotëson asnjërin nga kushtet e parapara me nenin 71, par 1, të LPP-së.

Gjykata vlerëson se urdhri për përmbarim i atakuar me prapësim, i lëshuar nga përmbaruesi privat B.T., është i ligjshëm dhe i rregullt dhe se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore, ngase përmbaruesi privat në këtë rast e ka lejuar përmbarimin në bazë të nenit 21 dhe 22, par 1, nën par 1.2, të LPP-së.

Sa i përket pretendimeve të debitorit në prapësim se : aktvendimi sipas të cilit është nxjerr urdhri për përmbarim është nxjerr në kundërshtim me të drejtën materiale edhe për këtë tash më kemi filluar edhe procedurën gjyqësore për konstatimin e kundërligjshmërisë së këtij vendimi i cili është objekt i urdhrorit për përmbarim , asnjëra nga bazat ligjore në hyrje të aktvendimit objekt të urdhrorit përmbarimor nuk i siguron të drejtën kreditorit të vendos gjobë ndaj debitorit . Neni 40 i Ligjit për produkte dhe pajisje medicinale për donacionet e përcakton se autoritet kompetent për mbikëqyrjen, deponimin, etiketimin dhe distribuimin e produkteve medicinale të dhuruara donacione është agjensioni i barnave për produkte dhe pajisje midicinale, gjykata këto pretendime i konsideron të pa bazuara sepse fakti që debitori ka ushtruar padi për ngritje të konfliktit administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamenti për çështje administrative nuk është pengesë për përmbarimin e vendimit mbi shqiptimin e gjobës në këtë rast. Për më tepër në bazë të nenit 22, par 1, të Ligjit për Konfliktet Administrative është paraparë shprehimisht se: *“Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe”*.

Gjithashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk është kompetencë e saj që ta vlerësoj ligjshmërinë e nxjerrjes së vendimit mbi shqiptimin e gjobës ndaj debitorit në këtë rast përveç që ka kompetencë ta bëj vetëm vlerësimin e ligjshmërisë së urdhrorit për përmbarim ndaj të cilit është ushtruar prapësim nga debitori dhe vlerësimit të vendimit mbi shqiptimin e gjobës gjithmonë sa i përket cilësimit të tij si dokument përmbarimor se a i përmbush kushtet ligjore nga neni 22, par 1, nën par 1.2, të LPP-së.

Po ashtu, Gjykata konstaton se vendimi mbi shqiptimin e gjobës Nr:10/ AI-020-19, datës 26.09.2019, i plotëson edhe kushtet ligjore nga neni 36, par 1, të LPP-së, për shkak se vendimi i përmendur më lartë njëjti është i pajisur me klauzolën e përmbareshmërisë për përmbareshmëri, respektivisht është i formës së prerë me datën 30.06.2022 dhe i ekzekutueshëm nga data 30.06.2022.

Po ashtu vendimi i cekur më lart është i përshtatshëm për përmbareshmëri dhe në pajtim me nenin 27, par 1, të LPP-së, ngase në të është treguar kreditori dhe debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbareshmërisë së detyrimit.

Si përfundim, gjykata konstaton se të gjitha faktet e cekura më lartë e bëjnë të ligjshëm, të drejtë, dhe në pajtim me nenin 22, par 1, nën par 1.2, të LPP-së, urdhrin për përmbareshmëri P.nr.460/22, të datës 02.09.2022, të nxjerrë nga përmbareshmëri privat B.T.

Andaj, Gjykata duke i marr parasysh thëniet e të autorizuarit të debitorit në prapësim, si dhe duke i marr parasysh provat dhe shkresat tjera të lëndës, konstaton se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi që të njëjtin ta refuzoj në tërësi si të pabazuar ndërsa urdhri për përmbareshmëri të mbetet në fuqi.

Nga të cekurat më lart dhe në bazë të nenit 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**PPP.nr.233/22, më datë 22.03.2024**

**GJYQTARI**

**Faton Ajvazi**

### **KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të kë